



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-91381

Dt. 19.07.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e _së **MIRI&Arkos Sh.P.K** me seli të objektit në rrugën “Ukë Bytyqi”-Prizren dhe me seli te investitorit ne rrugën “Isa Kastrati”, nr.4, në bazë të nenit 3 alineja 1 pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.7, 1.16, 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1 , e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 3 paragrafi 1 pika 1.6, 1.24 , 1.25 si dhe nenit 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 ,si dhe komfor nenit 33 paragrafi 1 pika 19 të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.001/001-46063 dt. 28.03.2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014,dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale Komunale(HZK)për periudhën 2022-2030-nr.001-011-48192 dt. 31.03.2022 e lidhur me nenin 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 27,44,46,47,48 si dhe nenit 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 merr këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	MIRI&Arkos Sh.P.K		
Adresa:	Rruga “Ukë Bytyqi”nr. / - Prizren		
Telefoni:	/	Emaili:	

Emri i projektit	Objekti – banim kolektiv me afarizëm –
Emri i projektuesit	“PROK”SH.P.K-Prizren
Adresa:	“ -/-” - Prizren

Telefoni:	/	Emaili:	
-----------	---	---------	--

Me këtë Vendim , aplikuesit për leje ndërtimore **MIRI&Arkos Sh.P.K** me seli të objektit në rrugën “ Ukë Bytyqi “ Prizren, me seli te investitorit ne rrugën “Isa Kastrati” nr.-/- i lejohet ndërtimi i objektit- **banim kolektiv me afarizëm** –në ngastrën kadastrale **P-71813068-11637-0 dhe 11638-0** Z. K. Prizren me sipërfaqe prej **7808 m² në rrugën** “Ukë Bytyqi”

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	ZK Prizren-KK Prizren	
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Prizren Objekti – banim kolektiv me afarizëm – me etazhitet – <u>blloku A(2B+P+8+Ph); blloku B(2B+P+8+Ph); blloku C(B+S+P+8+Ph); blloku D(B+S+P+8+Ph);</u> do të ndërtohet në parcelën kadastrale nr. P-71813068-11637-0 dhe 11638-0 Z. K. Prizren me sipërfaqe S=7808 m². Sipërfaqe bruto e Bllokut A është S=6494.4m². Sipërfaqe neto Bllokut A është S=4246.7m². Sipërfaqe bruto e Bllokut B është S=6428.1m². Sipërfaqe neto Bllokut B është S=4299.9m². Sipërfaqe bruto e Bllokut C është S=6697.6 m². Sipërfaqe neto Bllokut C është S=4717.5m². Sipërfaqe bruto e Bllokut D është S=6696.7m². Sipërfaqe neto Bllokut D është S=4696.9m². Sipërfaqe bruto e bodrumeve (A,B,C,D) është S=4430.4m². Sipërfaqe bruto e bodrumeve (A,B,C,D) është S=2981.6m². Sipërfaqe bruto objektit sipas taksës komunale është S=33729.0 m² Sipërfaqe neto objektit sipas taksës komunale është S=17961.9m²	b

- Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej **172,416.04 Euro.** **Etazhiteti i lejuar per këstin e parë eshte deri ne 2B+S+P+2 për të gjitha blloqet (A,B,C,D) në shumë prej 51,821.81 Euro,per vazhdimin e punimeve duhet te respektohet marrëveshja që është edhe me tre kështe te tjera,në të kundërtën mund të bëhet pezullimi i lejes ndërtimore**
- Paralogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **8,984,031.85€**

Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtimi i ri ☒	Rindërtim ☐	Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:		
Kategoria I ☐	Kategoria II ☒	
A përfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒		
Përdorimi i propozuar: objekti –banim kolektiv me afarizëm		

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **MIRI&Arkos Sh.P.K** i lejohet ndërtimi i objektit – banim kolektiv me afarizëm me etazhitet blloku A(2B+P+8+Ph); blloku B(2B+P+8+Ph); blloku C(B+S+P+8+Ph); blloku D(B+S+P+8+Ph);

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore
- Të vendosë tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistrin e hollësishëm ditë të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhënat e shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;

- Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga proejktuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rast kur:
 - Ndrysimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

MIRI&Arkos Sh.P.K ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e lejes ndërmore për **objektin – banim kolektiv me afarizëm;**
Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërmore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërmore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit,
- Pëlqimi nga “KEDS-i”,
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”,
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja,
- Pëlqim nga “Ekoregjioni”,
- Pëlqim nga Kompania Rajonale e Ujitjes-“Dugagjini”
- Aktvendim nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë,
- Vendim për Leje Mjedisore Komunale,
- Kater kopje të projektit kryesor dhe CD.

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR


Bashkëpunëtorë profesionale:



Egzona Morina-Thaqi ark.dipl.



DREJTORI



Pranverim Berisha jur.